

Forma e vetë deklarimit

Rezidenca tatimore e individëve privatë dhe Personave Fizikë (i zbatueshëm për CRS dhe FATCA)
Për kontratat bashkë emërore, secili anëtar duhet të plotësojë një formular të veçantë.

I. Identifikimi i anëtarëve, klientëve individë/ personave fizikë

Mbiemri(at), Emri(at):		
Data e Lindjes:	Qyteti i lindjes:	Shteti i lindjes:

Adresa e rezidencës aktuale ose vendbanimi i zakonshëm.
Shteti:
Rruga, Numri, Qyteti/Provinca: Ju lutemi përfshini të gjitha detajet në lidhje me adresën (pa shkurtime).

➤ **Ju lutem klikoni kutinë e duhur** (nëse është e aplikueshme): Jeni një shtetas amerikan (nga SHBA1)?

PO, TIN im SHBA-së është: _____ Ju lutemi, gjithashtu dorëzoni të plotësuar formularin W9 dhe deklaratën e Pëlqimit për FATCA- NO².

Jo

Deklaroj se nuk kam as vendbanim të përhershëm dhe as vendbanim të zakonshëm në Shqipëri sipas interpretimit të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 12.

Deklaroj se kam një vendbanim sekondar në Shqipëri sipas interpretimit të Ligjit nr 108/2013 për të Huajt. Ju lutemi paraqisni edhe kopjen e lejes së qëndrimit në Shqipëri në rast se nuk jeni rezident.

➤ **Në cilat vende keni residence tatimore³?**

Shteti:	Numri i Identifikimit Tatimor (TIN ¹):	Nëse TIN ¹) nuk mund te sigurohet ju lutemi paraqesni një arsyetim të vlefshëm:
Shteti:	Numri i Identifikimit Tatimor (TIN ¹):	Nëse TIN ¹) nuk mund te sigurohet ju lutem paraqesni një arsyeshëm të vlefshëm:

FOND PENSIONI

Në përgjithësi, një individ do të jetë rezident për qëllime tatimore në një juridiksion nëse, sipas ligjeve të këtij juridiksioni (përfshirë konventat tatimore), ai paguan ose duhet të paguajë tatimin në të për shkak të banesës, vendbanimit ose ndonjë kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe jo vetëm nga burimet në atë juridiksion

- 1) TIN= Numri I identifikimit te tatimpaguesit. TIN është numri i identifikimit personal për qëllime tatimore (Numri I identifikimit tatimor). Për informacione të mëtejshme, ju lutemi referojuni faqes ne internet të OECD-së <https://www.oecd.org/tax/automaticexchange/crs-implementation-and-assistance/tax-identification-numbers>. Personat që kanë residence në Shqipëri për qëllime ekskluzivisht tatimore do të paraqesin numrin e tyre personal. <https://www.oecd.org/tax/automaticexchange/crs-implementation-and-assistance/tax-identification-numbers/>.
- 2) Në rast identifikimi si resident i SHBA-së, kompania rezervon të drejtën të kërkojë gjithashtu formularin e IRS E-8BEN nëse e vlerëson të nevojshme.
- 3) Ligjet e brendshme të juridiksioneve të ndryshme përcaktojnë kushtet në të cilat një individ duhet të trajtohet si "rezident" tatimor. Në përgjithësi, një individ do të jetë rezident për qëllime tatimore në një juridiksion nëse, sipas ligjeve të këtij juridiksioni (përfshirë konventat tatimore), ai paguan ose duhet të paguajë tatimin në të për shkak të banesës, vendbanimit ose ndonjë kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe jo vetëm nga burimet në atë juridiksion. Për informacione të mëtejshme, ju lutem klikoni në faqen e mëposhtme : <https://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/crs-implementation-and-assistance/tax-residency/>
- 4) Ju jeni amerikan nëse jeni një qytetar amerikan ose një i huaj rezident i Sh.B.A. Ju jeni shtetas i SH.B.A.-së nëse keni lindur në Shtetet e Bashkuara, Commonëealth-in e Porto Rikos, Guam, ose U.S Virgin Islands ose në Commonëealth-in e Ishujve Mariana Veriore-Northern Mariana Islands (pas 3 nëntorit 1986) ose nëse jeni një qytetar i natyralizuar amerikan . Nëse të paktën njëri prej prindërve tuaj është një shtetas I SHBA-së, kërkesat e tjera duhet të përmbushen, sikur të jeni shtetas amerikan <https://www.irs.gov/>. Ju jeni një I huaj resident I SHBA-së nëse keni apo keni patur një Green card të SHBA-së ose përmbushni testin e pranisë thelbësore (Substantial presence test). Ju lutemi keshillohuni me këshilltarin tuaj të taksave për përcaktuar se cili lloj I Kartës së Gjelbër të SHBAS-së mund t'ju kualifikojë si një person amerikan. Ju lutemi vizitoni www.irs.gov për më shumë informacion në lidhje me Kartën e gjelbër amerikane dhe testin e pranisë thelbësore (substantial presence test). Nëse keni lindur në Shtetet e Bashkuara, por nuk jeni shtetas i SH.B.A.-së, ju lutemi paraqesni dokumenta shtesë vërtetuese: përveç kopjes së një pasaporte të vlefshme jo të SHBA-së ose një letërnjoftimi jo të SHBA (jo patentë), ju lutemi paraqesni një kopje të Certifikatës së Humbjes së Kombësisë (formulary DS-4083) se Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose një document tjetër zyrtar që mohon shtetësinë e SHBA ose një shpjegim të arsyetuar pse nuk e keni marrë nënshtetësinë e SHBA në lindje. Për informacion të mëtejshëm, ju lutemi referojuni faqes së mëposhtme: www.irs.gov/

Ju lutemi, jepni një shpjegim të arsyeshëm dhe dokumentacionin përkatës mbështetës, nëse rezidenca(t) juaj tatimore ndryshojnë nga shteti apo vendbanimi juaj aktual.

FOND PENSIONI

II. Deklarata dhe Nënshkrimi

Unë vërtetoj se jam Mbajtësi i kontratës (ose jam i autorizuar të nënshkruaj për Mbajtësin e kontratës) për kontratën/ (at) me të cilat lidhet ky formular.

Unë pranoj që sipas dispozitave të Ligjit Nr. 4/2020 "Për shkëmbimin automatik të informacionit", Ligjin Nr.9887 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe Rregulloren (BE) 2016/679 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, informacionet e përfshira në këtë formular dhe informacioni në lidhje me llogarinë (të) e njësisë ekonomike mund t'i raportohet autoriteteve tatimore të vendit në të cilin kjo/këto llogari (të) mbahen dhe shkëmbehen me autoritetet tatimore të një vendi tjetër ose të vendeve në të cilat njësia ekonomike (ose në disa rastet personi / at kontrollues) mund të jetë rezident tatimor kur ato vende kanë hyrë në marrëveshje për të shkëmbyer informacione mbi llogaritë financiare, apo dhe prane IRS nese sipas FATCA kjo eshte e detyrueshme, dhe qe lidhet me residence, nenshtesi, vendlindje ne USA apo cdo kriter tjetër qe me lidh me USA si vend tatimor.

Në lidhje me penalitetet për dëshmi të rreme, unë deklaroj se kam ekzaminuar informacionin mbi këtë formë dhe në dijeni time janë të vërteta, të sakta dhe të plota. Konfirmoj që do të informoj SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA nëse ndonjë informacion i deklaruar në këtë formular ndryshon dhe do të paraqes një formular të ri brenda 30 ditëve.

Unë e kuptoj dhe jam dakord që ky vetë-deklarim është i vlefshëm për SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA, si dhe për degët e tjera apo shoqëritë kontrolluese të kompanisë. Unë pranoj që të gjitha deklaratat e bëra në këtë formular janë në dijeninë dhe besimin tim të sakta dhe të plota. Unë marr përsipër të informoj SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA brenda [30] ditëve për çdo ndryshim të rrethanave që prek statusin e rezidencës tatimore të individit të identifikuar në këtë formular, ose l bën informacionet e përfshira këtu të pasakta ose të paplota, si edhe të sjell një formular vetë-deklarimi të përditësuar brenda 30 ditëve nga ndryshimi.

Emer, Mbiemer: *

Firme: *

Data: *

Shënim: Nëse nuk jeni Mbajtës i kontratës, ju lutemi tregoni statusin ligjor me të cilën po firmosni formularin.

Nëse nënshkruani si "Person I Autorizuar me prokurë", ju lutemi bashkëngjitni edhe një kopje të prokures apo dokumentit ligjor të përfaqësimit:

Në cilësinë e: *

Emri, Mbiemri
(Firme)

Data: *

SHPJEGIME –SHKURTIME TE PERDORURA APO SHPJEGIMI I KONCEPTEVE

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këto përkufizime ose kërkoni detaje të mëtejshme se si ta plotësoni këtë formë, ju lutemi kontaktoni këshilltarin tuaj tatimor ose autoritetin e taksave lokale. Për informacion shtesë në lidhje me Shkëmbimin automatik të informacionit, ju lutemi referojuni faqes zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c/6/455/shkembimi-automatik-i-informacionit>.

CRS = CRS është një shkurtim për Standardin e Përbashkët të Raportimit; CRS është standardi i përbashkët global i OECD për shkëmbimin automatik të informacionit për llogaritë financiare midis vendeve që kanë lidhur Marrëveshjen Shumëpalëshe midis Autoriteteve Kompetente. CRS zbatohet në Shqipëri me Ligjin Shqiptar 4/2020.

FATCA = FATCA është një shkurtim për Aktin e Pajtushmërisë së Taksave në Llogaritë e Huaja. Ky legjislacion tatimor i Shteteve të Bashkuara ka për qëllim identifikimin e Personave nga Sh.B.A që mbajnë llogari ose pasuri financiare jashtë Shteteve të Bashkuara. SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA sh.a është një kompani me aksioner mazhoritar (kontrolues) me seli në AUSTRI. Nisur nga fakti se Qeveria e Republikës së Austrisë ka lidhur një marrëveshje me qeverinë e Shteteve të Bashkuara të quajtur "Marrëveshje midis Republikës së Austrisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës për bashkëpunim për të lehtësuar zbatimin e FATCA", SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA, si pjesë e Grupit UNIQA, është e detyruar të plotësojë kërkesat e FATCA dhe e zbaton FATCA si FFI Pjesëmarrëse në një Vend jo IGA.

Rezidenca tatimore = Sipas ligjit shqiptar nr 9920 datë 19.05.2008, neni 8 "Për procedurat tatimore" Ju jeni rezident tatimor në Shqipëri nëse vendbanimi juaj i përhershëm ose i zakonshëm është në Shqipëri. Në përgjithësi, rezidenca juaj tatimore është e njëjtë me vendbanimin tuaj të përhershëm ose të zakonshëm. Sidoqoftë, secili vend ka rregullat e veta për përcaktimin e rezidencës tatimore. Ju mund ta kontrolloni këtë me legjislacionin lokal ose duke vizituar faqen <http://www.oecd.org/tax/automatic-exchange/crs-implementation-and-assistance/tax-residency/>. Ju lutemi këshillohuni me një këshilltar tatimor nëse nuk jeni të sigurt se si të përcaktoni rezidencën tatimore

Përkuizimi i banesës

Një person ka një vendbanim sipas nenit 12 të Kodit Civil, aty ku ai / ajo ka një rezidencë që e zotëron dhe do ta përdorë vazhdimisht dhe jo përkohësisht. "Vendbanim" do të thotë dhoma të mobiluara që mund të përdoren në çdo kohë për nevoja personale pa modifikime të rëndësishme, p.sh. banesa me qira, shtëpi pushimi, dhoma me qira, dhoma hotelesh të marra me qira në mënyrë të përhershme, dhoma në banesën e prindërve të personit, etj. Një person mund të ketë disa vendbanime.

SHËNIM: Banesat që janë të pabanuara ose të pamobiluara ose janë lënë në përdorim në mënyrë të përhershme tek të tjerë nuk përbëjnë një vendbanim në Shqipëri.

Përkufizimi i vendbanimit të zakonshëm

Një person ka një vendbanim të zakonshëm në kuptim të Ligjit nr 108/2013 për të Huajt dhe Ligjit 9920 datë 19.05.2008

"Për procedurat tatimore", ku ai / ajo është izikisht i pranishëm në atë mënyrë që tregon se prania e tij / saj në atë vend ose vendi nuk është thjesht i përkohshëm. Një person konsiderohet se ka vendbanimin e tij / saj të zakonshëm në Shqipëri nëse ai / ajo qëndron në Shqipëri për një periudhë më të gjatë se 183 ditë nga 365 ditë (kjo periudhë kohore pezullohet nga qëndrimet e përkohshme jashtë Shqipërisë).

Përkufizimi i vendbanimit dytësor në Shqipëri

Një person ka një vendbanim dytësor në Shqipëri, në zbatim të ligjit nr 108/2013 për të Huajt, nëse shumica e veprimtarive dhe qendra e interesit të këtij personi ndiqen jashtë Shqipërisë për më shumë se pesë vjet kalendarik, dhe apartamenti shqiptar, qoftë vetëm ose së bashku me apartamente të tjera në Shqipëri, nuk përdoret më shumë se 70 ditë në një vit kalendarik. Personi duhet të ketë të regjistruar numrin e ditëve kur një apartament i tillë përdoret në Shqipëri. Mbi dhe përtej kësaj, nuk ka vendbanim në Shqipëri të asnjë bashkëshorti ose partneri, i cili i nënshtrohet një detyrimi tatimor të pakufizuar nga i cili personi është ndarë përgjithmonë.